

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL
Nr. _____ Prot.

Tel (35542) 22979
Fax (35542) 34052

Tiranë, më 20.11.2001

U R D H E R

Nr. _____ Date _____ 2001

572 23.11.

PER

Themelimin e Shoqerise "TRANSNAFTA" SHPK Patos

Ne mbështetje te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 01.09.1997 " Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 7926 dt 20.04. 1995 " Per Transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregtare", ndryshuar me Ligjin 8482 dt 10.05.1999 " Per nje shtese ne ligjin nr. 7926 date 20.04.1995 ", ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare", dhe ne nenin 6 te Statutit te shoqerise "Albanian Petroleum Corporation " (APC) SHA Tirane

Urdheroj

1. Te themelohet shoqeria " Transnafta " Patos, me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.
2. Kapitali themeltar i shoqerise " Transnafta " SHPK Patos te jete 60.000.000 (gjashtedhjetemilion) leke i ndare ne 60.000 pjese te barabarta. Kapitali themeltar krijohet nga kontributet ne natyre te shoqerise "Servcom" Sha Fier.
3. Kapitali themeltar dhe pjeset e barabarta te tij zoterohen ne masen 100% nga shoqeria kontrolluese " Albanian Petroleum Corporation " (APC) Sha Tirane.
4. Dokumentat e themelimit, Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqerise " Transnafta " Patos, te firmosen nga Drejtori i Pergjithshem i shoqerise " Albanian Petroleum Corporation (APC) Sha Tirane.
5. Ngarkohet shoqeria " Albanian Petroleum Corporation " (APC) Sha. Tirane per zbatimin e ketij URDHERI.

Nje kopje e dokumentave te regjistrimit ne Gjykate dhe ne organet tatimore te depozitohet prane Drejtorise se Administrimit te Prones Publike ne Ministrine e Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE
Nr. 27/166

V E N D I M

“Për regjistrimin e personit juridik “

Sot, më datën 25/01/ 2002 (dymijëedy) unë gjyqtarja e Gjykatës së shkallës së parë Tiranë 2 Pajz, pasi shqyrtova kërkesën e paraqitur nga administratori Ludovik Taraj dhe dokumentat e paraqitura për regjistrimin e shoqërisë tregtare “Transnafta” SHPK Patos

KONSTATOVA SE :

Kërkuesi, ka paraqitur dokumentacionin për regjistrimin si person juridik të shoqërisë tregtare “Transnafta” Patos, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria “Albanian Petroleum Corporation” (APC) SH.A. Tiranë, e regjistruar rregullisht me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.20935 datë 02.03.1999, bazuar në Urdhërin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr.572 datë 23.11.2001, është ortak i vetëm dhe ka nënshkruar rregullisht aktet e themelimit.

Kapital themeltar i shoqërisë është 60 000 000 (gjashtëdhjetëmililion) lekë. Kapitali është vlerësuar në bazë të kontributeve në natyrë që u ndanë nga shoqëria "Servcom" SH.A. Fier, në bazë të planit të ndarjes të depozituar pranë kësaj Gjykate. Kapitali është vlerësuar sipas raporteve të ekspertëve të emëruar nga Gjykata,

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është kryerjen e shërbimeve të transportit për sektorin e naftës e për të tretët si dhe kryerja e shërbimeve të ndryshme për mirëmbajtjen e riparimin e çdo lloji automjeti apo makinerie.

Shoqëria do të zhvillojë edhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm në interes të shoqërisë e në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar. Selia e saj është në qytetin e Patosit.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, raportet e ekspertëve dhe kërkesa për regjistrimin e shoqërisë tregtare me përgjigje të kufizuar si person juridik janë të plota dhe të bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të pranohen.

01/0002

PER KETO ARSYE:

Ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe nenit 33 te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te"

VENDOSA:

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjigje te kufizuar "Transnafta" Patos, me kohezgjatje pa afat te caktuar me kapital themeltar 60 000 000 (gjashtëdhjetëmilion) lekë të ndarë në 60 000 pjesë të barabarta, secila me vlerë nominale 1000 leke, me ortak te vetem shoqerine "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tiranë dhe me objekt veprimtarie kryerjen e shërbimeve të transportit për sektorin e naftës e për të tretët si dhe kryerja e shërbimeve të ndryshme për mirëmbajtjen e riparimin e çdo lloji automjeti apo makinerie/_____

Shoqeria do te zhvilloje edhe aktivitete te tjera te mundshme ne interes te shoqerise e ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Administratori i shoqerise eshte Z.Ludovik Taraj.

Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne shkalle te dyte.

GJYQTARE

L. P. P. P.
01/0002

URDHËR REGJISTRIMI

Kolona I	Numri i Regjistrimit Tregtar: <u>27166</u>
Kolona II	A. Emri i Shoqërisë: <u>"Grouppa" Mpl.</u> B. Selia: <u>Rr. 105</u> C. Objekti: <u>Kupje e Kërkimesh të ndryshme për minierat e zezë dhe të bardhë</u> D. Kapitali: <u>60.000.000 (qarkullim në bankë)</u> <u>(Qarkullim në bankë F. Hoxha dhe G. Plesha)</u>
Kolona III	A. Ortakët: <u>Albomir Petrokum Corporation</u> <u>St. e. 100%</u> <u>Regjistruar me vendosim nr. 208350/2151999.</u> B. Administratorët: <u>Ludovik Goroj (përmes ligjit)</u> <u>e pasur ligj nga ndalo H. Robo (nr. 10258)</u> <u>dat 10/12/2001)</u> X X
Kolona IV	Kohëzgjatja: <u>se përfunduar.</u>
Kolona V	Shënime mbi aktet e shoqërisë: A. Data e Nënshkrimit: <u>10/12/2001</u> B. Data e regjistrimit: <u>25/01/2002</u> C. Statuti fletë: <u>8 fletë nr. 10254/15600/10/12/2001, H. Robo</u> D. Akti i Themelimit fletë: <u>3 fletë nr. 10256/15590/10/12/2001 H. Robo</u>

Shënime: U verifikua dhe.

Legjislacioni dhe aktet e tjera

GJYQTARE
REGLETA PANAJOTI

[Signature]

AKT THEMELIMI



Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", mbeshtetur ne Urdherin e Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit nr.572 date 23.11.2001, është ka vendosur :

Neni 1

Te themelohet shoqeria "Transnafta", me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2

Shoqeria "Transnafta" SHPK eshte shoqeri e kontrolluar, që zotërohet nga ortaku i vetëm, shoqeria "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane.

Neni 3

Selia e shoqerise "Transnafta" eshte ne qytetin e Patosit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Kryerja e sherbimeve të transportit për sektorin e naftës e për të tretët si dhe kryerja e shërbimeve të ndryshme për mirëmbajtjen e riparimin e çdo lloji automjeti apo makinerie.

Shoqeria do te zhvilloje edhe aktivitete te tjera te mundshme ne interes te shoqerise e ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 60 000 000 (gjashtëdhjetëmilion) leke dhe i zoteruar teresisht nga shoqeria "Albanian Petroleum Corporation"(APC) SH.A. Tirane.

Neni 6

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja
- Administratoret

Neni 7

Veprimtaria e organeve drejtuese te shoqerise eshte e mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi dhe ne normat e Statutit te shoqerise. Numri i administratorëve përcaktohet në Statut.

Neni 8

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne gjithë teritorin e vendit. Qendra e veprimtarisë së saj është në qytetin e Patosit, por ajo mund te kryejë sherbime, qe perfshihen ne objektin e veprimtarise, per persona të tretë ne çdo rreth te vendit.

Neni 9

Shoqeria themelohet per te vepruar ne nje afat te pacaktuar. Megjithate ajo mund te mbyllë veprimtarinë e saj me vendim të Asamblesë ose ne rastet e parashikuara me ligj.

Neni 10

Ne rast privatizmi do te respektohen dispozitat ligjore ne fuqi për privatizimin e shoqërive me kapital shtetëror.

Neni 11

Dispozita te hollesishme per veprimtarine e shoqerise percaktohen ne Statut.


SHOQERIA "APC" SH.A. TIRANE

Me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Kastriot BEJTAJ

KASTRIOT BEJTAJ



Tirane, me2001

STATUTI
I SHOQERISE "TRANSNAFTA" SHPK PATOS



Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te Urdherit te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.572 date 23.11.2001 dhe te Aktit te Themelimit, shoqeria "APC" SH.A. Tirane nxjerr kete Statut me kushtet e meposhteme:

KREU I

Emertimi, selia, afati

Neni 1

Eshte themeluar shoqeria "Transnafta", me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar. Shoqeria "Transnafta" SHPK eshte shoqeri e kontrolluar nga shoqeria "APC" SH.A. Tirane.

Neni 2

Shoqeria eshte themeluar per te vepruar ne gjithe territorin e vendit, per nje afat te pacaktuar.

Neni 3

Shoqeria e ka seline e saj ne qytetin e Patosit. Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 4

Ne veprimtarine e saj shoqeria zbaton legjislacionin shqiptar, normat e percaktuara ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut. .

KREU II

Objekti i veprimtarise

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte

Kryerja e shërbimeve të transportit për sektorin e naftës e për të tretët si dhe kryerja e shërbimeve të ndryshme për mirëmbajtjen e riparimin e çdo lloji automjeti apo makinerie.

Shoqeria do te zhvilloje edhe aktivitete te tjera te mundshme ne interes te shoqerise e ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te realizohet ne gjithë shoqëritë që përbëjnë sektorin e naftës, por dhe ne çdo vend tjeter jashte këtij sektori, ku shoqeria do te mund te siguroje porosi nga persona te trete shteterore apo private.

KREU III

Kapitali themeltar

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 60 000 000 (gjashtëdhjetëmilion) lekë. Ai eshte i shprehur ne para e në kontribute në natyrë dhe eshte i likujduar plotesisht para depozitimit te akteve te themelimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Neni 8

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 60 000 pjese te barabarta, secila me vlere nominale 1000 leke. Te gjitha pjeset e barabarta zoterohen nga shoqeria "Albanian Petroleum Corporation" SH.A. Tirane, qe eshte dhe ortak i vetem i shoqerise

Neni 9

Pjeset e barabarta te kapitalit themeltar mund te transferohen tek te tretet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me dispozitat ligjore te privatizimit te prones shteterore.



Neni 10

Zmadhimi e zvoglimi i kapitalit themeltar, me kontribute ne para ose ne natyre, u nenshtrohet dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 11

Ortaku i vetëm pergjigjet per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kontributit ne kapitalin themeltar.

KREU IV

Organet drejtuese

Neni 11

Organet drejtuese te shoqerise jane:

3. Asambleja
4. Administratoret

Neni 12

Asambleja e shoqerise perbehet nga ortaku i vetem, shoqeria "Albanian Petroleum Corporation" SH.A. Tirane. Ne mbledhjen e Asamblese shoqeria "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. perfaqesohet nga Drejtoria e shoqerise "APC" SH.A.


Neni 13.

Asambleja e shoqerise thirret jo me rralle se nje here ne vit. Mbledhjet e saj zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne rendin e dites.

Neni 14

Te drejten dhe detyrimin per thirrjen e mbledhjes se Asamblese e kane:

- d) Administratoret
- e) Ekspertet kontabel te autorizuar
- f) Asambleja mund te thirret edhe me iniciativen e ortakut te vetem kur ky i fundit e gjykon te arsyeshme mbledhjen e Asamblese.



Neni 15

Ne çdo rast administratoret janë përgjegjës për përgatitjen dhe mbarevajtjen e mbledhjeve të Asamblese.

Neni 16

Ne mbledhjen e Asamblese marrin pjesë, pa të drejtë vote, administratoret dhe ekspertët kontabel të autorizuar.

Neni 17

Ne mbledhjet e Asamblese mbahet procesverbal. Asambleja merr vendime që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga administratoret dhe gjithë personat e tjerë që kanë lidhje me shoqërinë.

Neni 18

Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Funksionimi i saj bëhet në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Asambleja miraton programet e zhvillimit, bilanci financiar, strukturën organizative të shoqërisë dhe rregullat e veprimit të saj, përdorimin e fondeve, pagën mesatare, marrjen e huave e kredive, dhenien e dorzaneve apo lenien peng, kontratat e veprimtarisë me afat me shumë se 1 vit, hapjen apo mbylljen e njësive si dhe çdo funksion tjetër që ligji e ka vendosur në kompetencë të Asamblese.

Neni 19

Drejtimi i zakonshëm i veprimtarisë së shoqërisë u përket administratorëve. Shoqëria drejtohet nga një administrator.

Neni 20

Administratoret emërohen nga Asambleja për një periudhë 2 vjeçare. Në aktin e emërimit përcaktohet dhe shpërblimi për punën e tyre.

Administrator i shoqërisë për periudhën e parë dy vjeçare emërohet Ludovik Taraj.

Kur ka më shumë se një administrator kompetencat e secilit prej administratorëve do të përcaktohen me vendim të posaçëm të Asamblese.

Neni 21

Administratoret mund te shkarkohen edhe para afatit te percaktuar ne nenin 20 per shkaqe te arsyetuara e qe lidhen me veprimtarine e tyre ne drejtimin e shoqerise.

Neni 22

Administratori perfageson shoqerine ne raport me te tretet. Aktet e tij kanë fuqi kur ato janë konform ligjit dhe përcaktimeve të Statutit.

Neni 23

Administratoret u nenshtrohen te gjitha kufizimeve e ndalimeve te percaktuara ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Ata kryejne te gjitha veprimet e nevojshme per administrimin e perditshem te veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre te percaktuara ne nenin 18 te ketij Statuti.

Neni 24

Administratoret pergjigjen per veprimtarine e tyre dhe te shoqerise para Asamblese. Ata jane te detyruar qe t'i paraqesin Asamblese raporte tremujore e vjetore per administrimin e shoqerise ne periudhat perkatese.

Neni 25


Marredheniet e punes me shoqerine rregullohen sipas legjislacionit te punes ne fuqi. Administratoret jane pergjegjes per respektimin e legjislacionit te punes.

KREU V

Viti ushtrimor dhe kontrolli financiar

Neni 26

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik. Ben perjashtim viti i fillimit te veprimtarise kur si date e fillimit te vitit ushtrimor do te konsiderohet data 01.01.2001.



Neni 27

Shoqëria do të mbaje një kontabilitet të rregullt gjatë veprimtarisë dhe do të pasqyrojë në inventare saktësisht pasurinë e saj. Kontabiliteti, llogarite e inventaret do të jenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 28

Në mbyllje të vitit ushtrimor hartohen llogarite e inventaret vjetore. Administratorët janë përgjegjës për hartimin e tyre.

Llogarite e inventaret vjetore u vihen në dispozicion eksperteve kontabel të autorizuar dhe së bashku me raportin e tyre i paraqiten Asamblesë, brenda afateve të përcaktuara në ligj ose me Vendim të Asamblesë.

Neni 29

Rezultati i ushtrimit të veprimtarisë përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave e shpenzimeve të ushtrimit.

Nga fitimet e ushtrimit, të pakesuara kur është rasti me humbjet e mëparshme, hiqet të pakten 5% për të krijuar rezervën ligjore. Krijimi i rezervës ligjore nuk është i detyrueshëm kur ajo arrijë 1/10 e kapitalit themeltar.

Çdo përdorim tjetër i fitimit të realizuar gjatë vitit ushtrimor përcaktohet nga Asambleja.


Neni 30

Dividenti i realizuar gjatë vitit ushtrimor i perket ortakut të vetëm.

Neni 31

Kontrolli i llogarive ushtrohet nga eksperte kontabel të autorizuar, që emërohen nga Asambleja dhe që kryejnë misionin e tyre në përputhje me ligjin.

Megjithatë Asambleja ka të drejtë të ushtrojë në çdo kohë kontrolle financiare të interesore apo me zgjedhje.



KREU VI

Dispozita te fundit

Neni 32

Shoqëria e mbyll veprimtarine e saj me Vendim te Asamblese ose kur jane rastet e parashikuara ne ligj.

Ne çdo rast te mbylljes se veprimtarise se shoqërise procedurat duhet te respektojne dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 33

Te ardhurat qe mbeten, mbas mbylljes se veprimtarise se shoqërise dhe shlyerjes se detyrimeve, i përkasin shoqërisë "Albania Petroleum Corporation"SH.A. Tiranë" me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 34

Për çdo gjë që nuk është shprehur posaçërisht në këtë Statut i referohet dispozitave ligjore për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të përcaktuara në ligjin nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".


SHOQERIA "APC"SHA

Me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Kastriot BEJTAJ

KASTRIOT BEJTAJ



Tiranë, më2001